

*Our Mission:  
Supporting improved  
educational opportunities for  
the children and youth of the  
isolated Malesia e Madhe  
region of Northern Albania*

President: Steve Cook, PhD

Secretary: Terri Cook

Board of Directors:

Karen Berg  
Mary Alice Seville  
Nancy Leeper  
Kristina Milaj  
Mona Jones-Romansic

Albania Manager:  
Marash Rakaj

Albanian Alps Institute  
8600 NW Oak Creek Drive  
Corvallis, OR 97330

Phone: 541-230-1285

Email: [albanianalpsinst@gmail.com](mailto:albanianalpsinst@gmail.com)

Website: [www.albanianalps.org](http://www.albanianalps.org)

## BURSISTE E AAI



Njihuni me Arjeta Curaj, një nga fitueset e bursave universitare të AAI. Arjeta vjen prej fshatit Zagor dhe ka përfundua shkollën e mesme në Koplik. Eshte një sfidë e madhe për studentat që vinë prej fshatrave të vegjël të ndjekin universitetin, por Arjeta ka marrë diplomën bachelor nga Universiteti i Tiranës dhe tani vazhdon studimet për master. Ajo ka studiuar me dedikim të madhë, dhe ne jemi shumë krenar për ndihmën që i kemi ofruar asaj në këtë përpjekje. Dega e saj e masterit është për mësuese matematikë dhe ajo shpreson të jap mësim për ciklin e mesem në Tiranë, pas diplomimit.

“Unë zgjodha matematikën, sepse ndihem e aftë, dhe ajo ka qenë gjithmonë dega ime e preferuar. Gjithashtu, e shoh mësimdhënjen si një profesion shumë human, pasi në ç’do moment, ti formon mendjen e fëmijëve dhe të rinjëve. Shpresoj të bëhem një mësuese e denjë që studentat të kenë besim dhe të ndihen rehat t’me bëjnë çfarëdo lloj pyetjeje.”  
Fat të mbarë, Arjeta!

### Kopshtet e Mbështetura nga AAI

Ne kemi furnizuar mjete mësimore për kopshtet e fëmijëve prej disa vite për shkollat në fshat; megjithatë ministria e arsimit ndërpreu kopshtet për fëmijë në Vrihtë dhe Bogë para dy vitesh. AAI j’u përgjigjë kësaj mangësie duke sponsorizuar mësues dhe mjete për dy orë në javë për fëmijët e kopshtit dhe të ciklit parashkollor. Ne jemi me fat që kemi dy mësuese të mrekullueshme, Regina Gocaj në Vrihtë, dhe Vitore Leshaj në Bogë të cilat janë duke bërë një punë shumë të mirë me fëmijët.



### Statistikat për Vitin Shkollorë 2018-19:

- 12 bursa për universitet
- 2 kopshte për fëmijë dhe 2 parashkolla
- Buxhet mujor për 5 shkolla për furnizimin e librarive me libra të ri
- Program stimulues për studentat në Shkollën e Mesme Dedaj
- Riparime në shkollën e Bogës

Shpenzimet e programit për vitin shkollorë 2017-18 ishin \$19,500. Tarifat administruese ishin 3.2% e shumës së programit.



### **Letër nga Presidentii AAI, Steve Cook**

Në udhëtimet e mia vjetore në Shqipëri, ritakohem me miqtë, kolegët, studentët, dhe malet. Pika kulmore e udhëtimit ishte konkursi i artit në Dedaj i organizuar nga Viki Leshaj. Studentë nga Boga, Xhaj, Dedaj, Vrithë, dhe Zagora paraqiten një koleksion të mrekullueshem të pikturave, vizatimeve, karaoke, valle moderne e tradicionale, këngë, dhe skica.

Kishte më shumë se njëqind student të pranishëm, si dhe shumë mësues dhe familjar. Santiljan Markvukaj dhe Rregjina Rakaj, studentë të bursave universitare të AAI, ishin juria që vlerësuan veprat e artit. Santiljani bëri fotografi gjatë aktivitetit, poashtu.

Dhashë mësim në “bashkëbisedim në Anglisht” në Bogë dhe Vrithë. Është gjithmonë një kënaqësi të korrespondosh me fëmijët, sidomos duke luajtur lojëra. Drejtori i shkollës së Vrithit, Gac Purashaj, më bindi që këndi i lojrave të fëmijëve ka nevojë për disa pajisje të reja. Ai është shumë i angazhuar për stërvitjen e fëmijëve. Gjithashtu, unë punova me miqtë e mi, Kola dhe Alban, për të bërë disa riparime në shkollën e Bogës. Pa fondet e AAI, shkolla në Bogë do shkonte në gjëndje tejet të keqe. Kur Terri, Marashi, dhe unë themeluan AAI në 2003, ne munduam se do vazhdonim dicka afatgjatë, ndoshta 10 vjet. Por donatorët tonë të dedikuar dhe zemërgjerë u kanë dhënë fëmijëve të Shkrelit një arsimim më të mirë për 15 vjet. Suksesi jonë është falë jush, dhe unë dua t’ju falendëroj për mirëbësimin tuaj në ne.

**amazon**smile  
Org Central

Amazon Smile është një mënyrë e thjeshtë dhe automatike për të mbështetur organizatën tuaj të preferuar bamirëse, pa ju kushtuar juve asnjë lek. Kur blini në [smile.amazon.com](https://smile.amazon.com), ju do gjeni ekzaksisht të njëjtat produkte dhe çmime si në Amazon.com, por me bonus, sepse Amazon do të dhurojë 0.5% të çmimit të artikujve që ju blini për organizatën tuaj të preferuar.

Herën e parë që shkoni në [smile.amazon.com](https://smile.amazon.com), hyni një lloj si tek Amazon.com. Atëherë përzgjidhni organizatën bamirëse që ju dëshironi të mbështesni (shpresoj që të jemi ne). Amazon e mban mend zgjedhjen tuaj dhe ç’do blerje e juaja nëpërmjet [smile.amazon.com](https://smile.amazon.com) rezulton në një donacion nga Amazon për organizatën që ju zgjedhët. Vetëm mbaj mend të shkoni në [smile.amazon.com](https://smile.amazon.com), hyr si zakonisht dhe vazhdoni blerjen!